



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 55/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.01.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-79321-11-20-2020, me objekt: Loti I “*Blerje bukë gruri dhe simite*”, me fond limit 12.046.516 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 16.12.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.”

Ankimues: “Dajti Park 2007” sh.p.k.
Rruga “Bardhok Biba”, Pallati “Trema”, Hyrja C, Kati 6, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Sheshi Skënderbej, Nr.3, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për*

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.11.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-79321-11-20-2020, me objekt: Loti I “*Blerje bukë gruri dhe simite*”, me fond limit 12.046.516 (pa TVSH), zhvilluar në datën 16.12.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 16.12.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 22.12.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|------------------------------|-------------------------------|
| 1. “M.C Catering” sh.p.k. | 9.666.684 lekë, skualifikuar |
| 2. “Dajti Park 2007” sh.p.k. | 10.461.110 lekë, skualifikuar |
| 3. “Kadra” sh.p.k. | 11.827.232 lekë, kualifikuar |

II.4. Në datën 22.12.2020 operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë:

• *Nuk arriti të plotësoj gërmën “c”), pika 4, seksioni 2.3, Kapacitetit Teknik, pika II, Kriteret e vecanta të kualifikimit, pasi në momentin e hapjes së ofertës nuk arriti të paraqes Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. Çertifikata për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, e paraqitur, është lëshuar për aktivitetin “hotel-restorant” dhe jo për një ambjent të përshtatshëm për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi.*

II.5. Në datën 28.12.2020 operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, me arsyetimin si më poshtë vijon:

[...]

S'kualifikimi i ofertes se shoqerise tone shoqerohet me arsyetimin se:

Nuk arriti te plotesoj germen "c", pika 4, seksioni 2.3, Kapaciteti Teknik, pika II, Kriteret e vecanta te kualifikimit, pasi ne momentin e hapjes se ofertes nuk arriti te paraqese Certificate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. Certificate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, e paraqitur, eshte leshuar per aktivitetin "hotel-restorant" dhe jo per nje ambjent te pershtatshem per prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi.

Ne analizuam me kujdes arsyetimin e AK dhe gjykojme se ai eshte teresisht i padrejte dhe i pabazuar per arsyet si me poshte:

Se pari sqarojme AK se ambjenti i paraqitur ne permbushje te kriterit kualifikues eshte pjese perberese e nje objekti ndertimor kompleks sipas certificate se pronesise te paraqitur me Nr 1347826 date 10.06.2016 dhe me Nr pasurie 18/89 leshuar nga ZRPP Tirane. Siperfaqja totale e kesaj pasurie sic tregohet te certificate te 3250 m2 pasuri e llojit truall nga te cilat ndertesa 700 m2. Ne kete kompleks ndertimor ben pjese nder te tjera hoteli, restoranti, furre buke, ambjente magazinimi etj. Ashtu sikunder paraqitet edhe ne certificaten per sigurine nga zjarri me Nr D-18723/1 Prot date 15.10.2020, kjo certificate eshte leshuar per siperfaqen e pergjithshme te objektit/aktivitetit/lartesia/numri i kateve/mbi/nen nivelin zero: Gjurma e pergjithshme 850 m2, Numri i kateve 3 (tre) + 2 (dy).

Pjese e kesaj siperfaqeje eshte edhe ambjenti i paraqitur ne permbushje te kriterit kualifikues, vertetuar kjo me planimetrine e ambjentit 310 m2 ne pronesi te shoqerise "Vllaznia (Dajti Park

2007)", siperfaqe kjo e ndodhur ne katin e pare te objektit me numer katesh 3 (tre) + 2 (dy) te certifikuar nga organi kompetent.

- Sqarojme edhe nje here AK se per nje objekt ndertimor kompleks nuk mund te leshohet certificate e vecante per cdo ambient perberes pasi projekti inxhinierik parashikon nderlidhje midis cdo kati dhe ambjenti perberes te te gjitha godines.

Ne aktin teknik te leshuar vertetohet fare qarte se:

Ka hidrante per cdo kat, Ka impiant hidrik antizjarr ne objekt, Ka impiante te fikseve te levizshme, Ka detektore tymi me temp 65 grade ne objekt, Ka sasi uji 5000 litra per shuarjen e zjarrit, Ka hapësira te lejuara per mjetet zjarrfikese.

Per sa me siper argumentuam, kerkojme pezullimin e vazhdimet te proceduren dhe kualifikimin e ofertes se shoqerise tone si oferte e cila ploteson te gjitha kushtet kualifikuese dhe me nje efekt te konsiderueshem prej 1366162 leke per buxhetin e shtetit.

II.6. Autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.2529/2 prot., datë 30.12.2020, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar atë:

[...]

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Dajti Park" SHPK, pretendimet e parashtruara ne ankesa mbi skualifikimin e ofertes se tij, konstatoi se:

Per ofertuesin "Dajti Park" SHPK, komisioni i vleresimit te ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 22.12.2020, skualifikimin e tij, arsyet e skualifikimit te ofertes se tij si vijon: "Nuk arriti te plotesoje germen "c"), pika 4, seksioni 2.3, Kapacitetit Teknik; pika II Kriteret e vecanta te kualifikimit, pasi ne momentin e hapjes se ofertes nuk arriti te paraqes Certificate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. Certificate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, e paraqitur, eshte leshuar per aktivitetin "hotel-restorant" dhe jo per nje ambient te pershtatshem per prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi".

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Dajti Park" SHPK dhe konstatoi:

Ne dokumentat e tenderit ne shtojcen 9 ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", seksioni 2.3 "Kapaciteti Teknik" pika 4, germa "c", percaktohet se operatori ekonomik pjesemarres, duhet te kete ne pronesi ose ne perdorim te pakten 1 (nje) ambient te pershtatshem per prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi, me siperfaqe te pakten 50 m2, per te cilin duhet te paraqes dokumentacionin perkates si me poshte: c) Certificate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj..."

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi "Dajti Park" SHPK ne permbushje te kriterit te sipercituar ka paraqitur dokumentacionin me emertimin "Ambjent_Furre _buke_Dajti-Park".

Pjese e dokumentacionit te sipercituar eshte "Certificate per Sigurine nga Zjarri (Ripoteritje per Lejim Aktiviteti)" e leshuar per "Emri/adresa e objektit: Z.Blerina Ceka, Subjekti "Dajti Park 2007" Rruga "Bardhok Biba" Tirane" me "Aktiviteti i ushtruar ne objekt: Restorant Hotel". Vihet re se edhe pse certificate per sigurine ndaj zjarrit eshte e leshuar ne emer te subjektit tregtar "Dajti

Park 2007" SHPK, ofertues ne kete procedure prokurimi, adresa dhe lloji i aktivitetit te cituara ne kete certifikate nuk perkojne me ambientin e ushtrimit te aktivitetit objekt prokurimit si dhe me objektin e prokurimit. Konkretisht, ne Certifikaten per Vertetim Pronesia te ngarkuar nga ofertuesi ekonomik "Dajti Park" SHPK ne sistemin e prokurimit elektronik adresa eshte "Priske e madhe" adrese e deklaruar prej tij si ambienti i pershtatshem per prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi, nderkohe qe Certifikata per sigurine nga zjarri eshte e leshuar per objekt me adrese "Rruga "Bardhok Biba". Gjithashtu, Certifikata per sigurine nga zjarri eshte e leshuar per aktivitetin "Restorant Hotel", aktivitet i cili nuk lidhet me proceduren prokurimit e cila ka si objekt "prodhime brumi".

Kriteret e vecanta per kualifikim kane si synim kryesor qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u perrnbushur nga operatoret ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit. Operatoret Ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme bazuar dhe ne piken I, te nenit 46 te Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar ku citohet: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese ... "Ne nenin 53 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, parashikohet se: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo i!shti! në perputhje me të gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij ligji."

Per arsyet e mesiperme pretendimi i ofertuesit "Dajti Park" SHPK nuk pranohet.

Sa me siper, ju bejme me dije se kunder vendimit te organit qendror bleres mund te behet ankim ne Komisionin e Prokurimit Publik, ne perputhje me nenin 63, pika 6, te LPP.

II.7. Në datën 06.01.2021 operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke pretenduar si më poshtë:

[...]

S'kualifikimi i ofertes se shoqerise tone shoqerohet me arsyetimin se:

Nuk arriti te plotesoj germen "c", pika 4, seksioni 2.3, Kapaciteti Teknik, pika II, Kriteret e vecanta te kualifikimit, pasi ne momentin e hapjes se ofertes nuk arriti te paraqese Certifikate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. Certifikata per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, e paraqitur, eshte leshuar per aktivitetin "hotel-restorant" dhe jo per nje ambjent te pershtatshem per prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi.

Ne analizuam me kujdes arsyetimin e AK dhe gjykojme se ai eshte teresisht i padrejte dhe i pabazuar per arsyet si me poshte:

Se pari sqarojme AK se ambjenti i paraqitur ne permbushje te kriterit kualifikues eshte pjese perberese e nje objekti ndertimor kompleks sipas certifikates se pronesis se paraqitur me Nr 1347826 date 10.06.2016 dhe me Nr pasurie 18/89 leshuar nga ZRPP Tirane. Siperfaqja totale e kesaj pasurie sic tregohet te certifikate te 3250 m2 pasuri e llojit truall nga te cilat ndertesa 700 m2. Ne kete kompleks ndertimor ben pjese nder te tjera hoteli, restoranti, furre buke, ambjente magazinimi etj. Ashtu sikunder paraqitet edhe ne certifikaten per sigurine nga zjarri me Nr D-18723/1 Prot date 15.10.2020, kjo certifikate eshte leshuar per siperfaqen e pergjithshme te objektit/aktivitetit/lartesia/numri i kateve/mbi/nen nivelin zero: Gjurma e pergjithshme 850 m2, Numri i kateve 3 (tre) + 2 (dy).

Pjese e kesaj siperfaqeje eshte edhe ambjenti i paraqitur ne permbushje te kriterit kualifikues, vertetuar kjo me planimetrine e ambjentit 310 m2 ne pronesi te shoqerise "Vllaznia (Dajti Park 2007)", siperfaqe kjo e ndodhur ne katin e pare te objektit me numer katesh 3 (tre) + 2 (dy) te certifikuar nga organi kompetent.

- Sqarojme edhe nje here AK se per nje objekt ndertimor kompleks nuk mund te leshohet certificate e vecante per cdo ambjent perberes pasi projekti inxhinierik parashikon nderlidhje midis cdo kati dhe ambjenti perberes te te gjithe godines.

Ne aktin teknik te leshuar vertetohet fare qarte se:

Ka hidrante per cdo kat, Ka impiant hidrik antizjarr ne objekt, Ka impiante te fikseve te levizshme, Ka detektore tymi me temp 65 grade ne objekt, Ka sasi uji 5000 litra per shuarjen e zjarrit, Ka hapesira te lejuara per mjetet zjarrfikese.

Në kushtet e skualifikimit të padrejte, me date 28.12.2020 ne iu drejtuam me ankese autoritetit kontraktor. Më datë 30.12.2020 kemi marrë përgjigje për mospranimin e ankesës së paraqitur prej nesh. Të ndodhur ne këto kushte po i drejtohem KPP për te fituar te drejten tone.

Per sa me siper argumentuam, kerkojme pezullimin e vazhdimit te proceduren dhe kualifikimin e ofertes se shoqerise tone si oferte e cila ploteson te gjitha kushtet kualifikuese dhe me nje efekt te konsiderueshem prej 1366162 leke per buxhetin e shtetit.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 55/1 prot., datë 13.01.2021, protokolluar me tonën në datën 18.01.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park” sh.p.k., për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin: [...] *Se pari sqarojme AK se ambjenti i paraqitur ne permbushje te*

kriterit kualifikues eshte pjese perberese e nje objekti ndertimor kompleks sipas certifikates se pronesise te paraqitur me Nr 1347826 date 10.06.2016 dhe me Nr pasurie 18/89 leshuar nga ZRPP Tirane. Siperfaqja totale e kesaj pasurie sic tregohet te certifikate te 3250 m2 pasuri e llojit truall nga te cilat ndertesa 700 m2. Ne kete kompleks ndertimor ben pjese nder te tjera hoteli, restoranti, furre buke, ambjente magazinimi etj. Ashtu sikunder paraqitet edhe ne certifikaten per sigurine nga zjarri me Nr D- 18723/1 Prot date 15.10.2020, kjo certifikate eshte leshuar per siperfaqen e pergjithshme te objektit/aktivitetit/lartesia/numri i kateve/mbi/nen nivelin zero: Gjurma e pergjithshme 850 m2, Numri i kateve 3 (tre) + 2 (dy).

Pjese e kesaj siperfaqeje eshte edhe ambjenti i paraqitur ne permbushje te kriterit kualifikues, vertetuar kjo me planimetrine e ambjentit 310 m2 ne pronesi te shoqerise "Vllaznia (Dajti Park 2007)", siperfaqe kjo e ndodhur ne katin e pare te objektit me numer katesh 3 (tre) + 2 (dy) te certifikuar nga organi kompetent.

- Sqarojme edhe nje here AK se per nje objekt ndertimor kompleks nuk mund te leshohet certificate e vecante per cdo ambjent perberes pasi projekti inxhinierik parashikon nderlidhje midis cdo kati dhe ambjenti perberes te te gjithe godines.

Ne aktin teknik te leshuar vertetohet fare qarte se:

Ka hidrante per cdo kat, Ka impiant hidrik antizjarr ne objekt, Ka impiante te fikseve te levizshme, Ka detektore tymi me temp 65 grade ne objekt, Ka sasi uji 5000 litra per shuarjen e zjarrit, Ka hapësira te lejuara per mjetet zjarrfikese. [...]", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9, Loti 1 “Blerje bukë gruri dhe simite”, në pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

- 1) *Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient të përshtatshëm për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi, me sipërfaqe të paktën 50 m², për të cilin duhet të paraqes dokumentacionin përkatës, si më poshtë:*
 - a) *Dokumentacioni që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen:*
 - *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*
 - *Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / kontrata e shitblerjes / kontrata e dhurimit / çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*
 - *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*
 - *Kontratë noteriale huapërdorje.*
 - *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*
 - *Kontratë qiraje.*
 - b) *Akt miratimi higjieno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.*
 - c) *Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.*
 - d) *Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të deklarojë plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për këtë ambient.*
 - e) *Foto të ambientit të brendshëm të prodhimit ose magazinimit të mallrave objekt prokurimi.*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k. në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Certifikatë pronësie për pasurinë me numër 18/89, z.k.3051, vol.11, fq.42, adresa e pasurisë “Priskë e Madhe”, me sip. Totale 3250 m2, ndërtesa 700 m2 në emër të “Vllaznia” sh.p.k. shoqëruar me Kartelën e Pasurisë së Paluajtshme dhe Harta treguese e regjistrimit, dokumentacion ky i lëshuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë datë 10.06.2016.
- Licencë II.1.A.(1), ku vendi i kryerjes së veprimtarisë është “Tiranë Dajt Priskë e Madhe Dajti Park”.
- Leje Mjedisore Tipi C, Kodi III.1.A, ku vendi i kryerjes së veprimtarisë është “Qarku: Tiranë, Rrethi: Tiranë, B/K: Dajt, Q/F: Priskë e Madhe”.
- Akt Miratimi Higjeno – Sanitar Nr.137 me adresë “Lagja Qesarak, Dajt, Tiranë, Nr.Pasurisë 18/89, Priskë e Madhe”.
- Çertifikatë për Sigurinë nga Zjarri (Ripërtëritje për lejim aktiviteti), me Nr.D-18723/1 prot. datë 15.10.2020, në emër të subjektit Z.B.C, Subjekti “Dajti Park 2007”, Rruga “Bardhok Biba”, Tiranë, Aktiviteti i ushtruar në objekt: Restorant Hotel, Sip. e përgjithshme e objektit “Gjurma e ndërtimit 850 m2, Numri I kateve 3 (tre) + 2 (dy), lëshuar nga Drejtoria e M.Z.SH.-së

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.4. Në ligjin nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, neni 3, pika 2, parashikohet:

“Certifikatë e mbrojtjes nga zjarri” është akti administrativ, i lëshuar nga shërbimi i MZSH-së, nëpërmjet të cilit provohet përmbushja e kërkesave të parashikuara në projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorizimit të objekteve.

Ndërsa në nenin 41 pika 3 e ligjit nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, parashikohet:

“3. Klasifikimi i objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e miratimit, koha dhe mënyra e shqyrtimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, që shoqërojnë dokumentacionin tekniko-ligjor, lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit, si dhe e lëshimit të certifikatës të mbrojtjes nga zjarri, miratohen me udhëzim të ministrit.”

Ndërsa në nenin 45 “Kontrolli teknik pas përfundimit të punimeve” parashikohet: *“Inspektorët e shërbimit të MZSH-së, në përfundim të punimeve të objektit, kontrollojnë zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të detyrave të lëna në projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin. Nëse janë*

respektuar kërkesat e projektit, drejtori/shefi i sektorit të shërbimit të MZSH-së jep certifikatën e sigurisë nga zjarri.”

III.1.5. Në Udhëzimin Nr.81, datë 06.03.2020 “Për klasifikimin e objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e shqyrtimit dhe të miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe dhënia e Certifikatës së Sigurisë nga Zjarri”, parashikohet:

III. PROCEDURA E LËSHIMIT TË CERTIFIKATËS SË SIGURISË NGA ZJARRI

1. Certifikata e Sigurisë nga Zjarri, në vijim “CSZ”, sipas formularit nr. 2 dhe 2.1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, është akti administrativ i lëshuar nga shërbimi i MZSH-së, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, nëpërmjet të cilit provohet përmbushja e kërkesave të parashikuara në projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorizimit të objekteve.

2. Aplikuesi për CSZ-në paraqet kërkesë nëpërmjet sistemit elektronik e-Albania, vetëm pasi ka përfunduar procesi i zhvillimit/i ndërtimit.

3. Kërkesa e aplikuesit për t’u pajisur me CSZ pranohet për vlerësim të mëtejshëm nga shërbimi i MZSH-së, në nivel vendor vetëm, në rastet kur:

a) aplikuesi legjitimohet për të paraqitur kërkesë;

b) provohet dhe dokumentohet shkresërisht procedura e miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objektin/aktivitetin;

c) vërtetohet gjendja faktike e marrjes së masave pasive/aktive të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me kushtet e lejes së zhvillimit/ndërtimit, si dhe dokumenteve të planifikimit;

d) është kryer pagesa e tarifës për marrjen e CSZ-së.

4. Në rast se aplikuesi nuk përmbush kriterin e përcaktuar në germën “b”, të pikës 3 të këtij kreu, informohet për të rifilluar procedurën e miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

5. Inspektori i autorizuar i shërbimit të MZSH-së në nivel vendor, gjatë këqyrjes së gjendjes faktike në objekt/aktivitet të masave pasive/aktive të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, ka për detyrë të:

a) plotësojë me përgjegjësi rubrikat e formularit nr. 3, “Vlerësimi i riskut nga zjarri”, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi;

b) të hartojë relacionin shpjegues lidhur me gjetjet gjatë inspektimit në objekt/aktivitet, për masat e mbrojtjes nga zjarri, të cilin e paraqet pranë drejtuesit të shërbimit të MZSH-së.

6. Shërbimi i MZSH-së, në rast se konstaton mospërputhje të punimeve me kërkesat e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, lëshon aktin e konstatimit, duke dhënë sugjerimet përkatëse dhe afatin kohor për plotësimin e mangësive. Në këtë rast, afati për lëshimin e CSZ-së pezullohet.

7. Nëse brenda afatit kohor të përcaktuar në aktin e konstatimit, sipas pikës 6 të këtij kreu, nuk përmbushen sugjerimet e shërbimit të MZSH-së, inspektorët vendorë të MZSH-së vendosin sanksione për administratorët e objektit/aktivitetit apo subjektet përgjegjëse, sipas parashikimit të ligjit për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin dhe aplikimi për lëshimin e CSZ-së refuzohet.

8. Shërbimi i MZSH-së lëshon CSZ, në rastet kur:

a) Relacioni shpjegues sipas germës “b”, të pikës 5 të këtij kreu, vërteton përmbushjen e detyrave të caktuara në projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

b) janë përmbushur kriteret e sigurisë, që kërkon legjislacioni për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, të pasqyruara nga inspektori i autorizuar në formularin nr. 3, “Vlerësimi i riskut nga zjarri”, në objekt/aktivitet.

9. Për objektet e kategorisë C, sipas pikës 1, të kreut I të këtij udhëzimi, inspektori i autorizuar i shërbimit vendor të MZSH-së, pas kërkesës së aplikuesit dhe pas verifikimit të kompetencës administrative, ka për detyrë të:

a) verifikojë në vend objektin, lidhur me marrjen e masave pasive/aktive të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me kushtet e lejes së zhvillimit/ndërtimit, si dhe dokumenteve të planifikimit;

b) dërgojë pranë shërbimit qendror të MZSH-së, relacionin shpjegues të firmosur elektronikisht nga drejtuesi i shërbimit, lidhur me masat pasive/aktive për mbrojtjen nga zjarri.

9.1 Shërbimi qendror i MZSH-së, për objektet e kategorisë C, vlerëson plotësimin e kushteve dhe të standardeve të sigurisë nga zjarri dhe, brenda 30 ditëve nga paraqitja e aplikimit, duhet të marrë vendim për lëshimin apo refuzimin e kërkesës së aplikuesit.

10. Në rast se gjatë monitorimit periodik të zhvillimeve në territor, përmes sistemit elektronik e-Leje apo gjatë kontrollit të veprimtarisë së strukturave të shërbimit të MZSH-së, konstatohet se për objektet me rëndësi ekonomike-strategjike kombëtare, që paraqesin rrezikshmëri të theksuar të rënies, përhapjes së zjarrit dhe shpërthim apo për zhvillimet komplekse, sipas rregullores së zhvillimit të territorit, projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin dhe CSZ-ja janë miratuar nga shërbimi vendor i MZSH-së, ndaj personave përgjegjës fillohet procedura e ecurisë disiplinore, sipas parashikimeve të legjislacionit për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

11. Afati i vlefshmërisë të CSZ është:

a) pa afat për objektet/aktivitetet të kategorisë A, sipas përcaktimit në germën “a”, të pikës 1, të kreut I të këtij udhëzimi;

b) me afat 5-vjeçar, me të drejtë ripërtëritje për objektet/aktivitetet të kategorisë B, sipas përcaktimit në germën “b”, të pikës 1, të kreut I të këtij udhëzimi;

c) me afat 3-vjeçar, me të drejtë ripërtëritje për objektet/aktivitetet të kategorisë C, sipas përcaktimit në germën “c”, të pikës 1, të kreut I të këtij udhëzimi.

12. Afatet e përcaktuara në gerrat “b” dhe “c”, të pikës 12 të këtij kreu, janë të vlefshme në rastet kur objektet/aktivitetet nuk ndryshojnë elemente thelbësore të strukturës së tyre apo nuk ndryshojnë destinacionin e përdorimit. Në rast të kundërt, pronarët apo administratorët e këtyre objekteve/aktiviteteve janë të detyruar të aplikojnë për miratim shtesë të projektit ekzistues të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe për ripërtëritje të CSZ-së, në përputhje me treguesit dhe mënyrat e ndërhyrjes në projekt, instalimet e reja, modifikim, zgjerim apo rikonstruksion I aktivitetit ekzistues.

13. Shërbimi i MZSH-së, në nivel vendor apo qendror, mund të revokojë CSZ të lëshuar, në rastet kur:

a) pas procedurës së inspektimit, kryesisht apo të autorizuar, objekti/aktiviteti nuk përmbush kushtet dhe standardet në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorizimit të objekteve;

b) nga inspektorët vendorë të shërbimit të MZSH-së konstatohen shkelje të rënda ose ndryshime thelbësore në kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë objekti/aktiviteti, sipas projektit të miratuar dhe certifikatës së lëshuar;

c) konstatohen të dhëna të rreme në dokumentet e aplikimit të subjektit.

14. Vendimi i marrë nga drejtuesi i shërbimit të MZSH-së për revokimin e CSZ-së duhet të jetë i arsyetuar dhe ndaj tij lejohet ankim në Gjykatën Administrative kompetente, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin përkatës në fuqi.

IV. PROCEDURAT E RIPËRTËRITJES SË CERTIFIKATËS TË SIGURISË NGA ZJARRI

[...]

3. Procedura për lëshimin e CSZ-së e parashikuar në kreun III të këtij udhëzimi, do të zbatohet edhe në rastin e ripërtëritjes periodike të saj.

III.1.6. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstatohet se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik, ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient të përshtatshëm për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi, me sipërfaqe të paktën 50 m², për të cilin ndër të tjera duhet të paraqesë Certifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

III.1.7. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k., ka paraqitur Certifikatë pronësie për pasurinë me numër 18/89, z.k.3051, vol.11, fq.42, adresa e pasurisë “Priskë e Madhe”, me sip. Totale 3250 m², ndërtesa 700 m², shoqëruar me Kartelën e Pasurisë së Paluajtshme dhe Harta treguese e regjistrimit; Licencë II.1.A.(1), ku vendi i kryerjes së veprimtarisë është “Tiranë Dajt Priskë e Madhe Dajti Park”; Leje Mjedisore Tipi C, Kodi III.1.A, ku vendi i kryerjes së veprimtarisë është “Qarku: Tiranë, Rrethi: Tiranë, B/K: Dajt, Q/F: Priskë e Madhe”; Akt Miratimi Higjeno – Sanitar Nr.137 me adresë “Lagja Qesarak, Dajt, Tiranë, Nr.Pasurisë 18/89, Priskë e Madhe” dhe Certifikatë për Sigurinë nga Zjarri (Ripërtëritje për lejim aktiviteti), me Nr.D-18723/1 prot. datë 15.10.2020, në emër të subjektit Z.B.C, Subjekti “Dajti Park 2007”, Rruga “Bardhok Biba”, Tiranë, Aktiviteti i ushtruar në objekt: Restorant Hotel, Sip. e përgjithshme e objektit “Gjurma e ndërtimit 850 m², Numri I kateve 3 (tre) + 2 (dy), lëshuar nga Drejtoria e M.Z.SH.-së.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, KPP konstaton se operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k., ka paraqitur dokumentacionin me anë të të cilit provon se disponon 1 (një) ambient për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi, me sipërfaqe të paktën 50 m², por Çertifikata për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, nuk është lëshuar për objektin për të cilin operatori ekonomik ka deklaruar se do të kryejë veprimtarinë objekt prokurimi. Adresa e objektit për të cilin është lëshuar -Çertifikata për Sigurinë nga Zjarri, është e ndryshme nga adresa e të gjithë dokumentacionit tjetër të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues për përmbushjen e pikës 2.3.4 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Konkretisht operatori ekonomik ankimues ka paraqitur Certifikatën e pronësisë për pasurinë me numër 18/89, z.k.3051, vol.11, fq.42, adresa e pasurisë “Priskë e Madhe”, me sip. Totale 3250 m², ndërtesa 700 m²; Licencën II.1.A.(1), ku vendi i kryerjes së veprimtarisë është “Tiranë Dajt Priskë e Madhe Dajti Park”; Leje Mjedisore Tipi C, Kodi III.1.A, ku vendi i kryerjes së veprimtarisë është “Qarku: Tiranë, Rrethi: Tiranë, B/K: Dajt, Q/F: Priskë e Madhe”; Akt Miratimi Higjeno – Sanitar Nr.137 me adresë “Lagja Qesarak, Dajt, Tiranë, Nr.Pasurisë 18/89, Priskë e Madhe”, ndërsa Certifikata për Sigurinë nga Zjarri (Ripërtëritje për lejim aktiviteti), me Nr.D-18723/1 prot. datë 15.10.2020, është lëshuar në emër të subjektit Z.B.C, Subjekti “Dajti Park 2007”, Rruga “Bardhok Biba”, Tiranë, ku aktiviteti i ushtruar në objekt: Restorant Hotel, Sip. e përgjithshme e objektit “Gjurma e ndërtimit 850 m²”, sipërfaqe kjo e ndryshme nga ajo e pasqyruara në certifikatën e pronësisë se objektit.

Sa më sipër, gjykojmë së operatori ekonomik ankimues, për ambjentin të cilin ka deklaruar se do të kryejë veprimtarinë objekt prokurimi, nuk ka paraqitur Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, sic kërkohet në dokumentat e tenderit.

Akoma më tej, referuar legjislacionit përkatës të fushës, konkretisht ligjit nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, dhe Udhëzimit Nr.81, datë 06.03.2020 “Për klasifikimin e objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e shqyrtimit dhe të miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe dhënia e Certifikatës së Sigurisë nga Zjarri”, konstatohet se Certifikata për Sigurinë nga Zjarri, lëshohet për çdo objekt të veçantë, pas verifikimit të kushteve për përcaktuara në legjislacionin e mësipërm.

III.1.8. Kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë fizike dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor. Në përfundim, konstatohet se Certifikata për Sigurinë nga Zjarri (Ripërtëritje për lejim aktiviteti), me Nr.D-18723/1 prot. datë 15.10.2020, e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” sh.p.k., nuk është lëshuar për objektin të cilin ankimuesi e ka deklaruar si ambjent për kryerjen e veprimtarisë objekt prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k. nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-79321-11-20-2020, me objekt: Loti I “Blerje bukë gruri dhe simite”, me fond limit 12.046.516 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 16.12.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 06 Protokolli

Datë 06.01.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri